



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCES-**

Njoftim për Shtyp

Mbi vendimin e Komisionit të Konkurrencës për procedurat e hetimit të thelluar në tregun në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës

Autoriteti i Konkurrencës, bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr.262, datë 14.01.2013 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës” ka ndjekur procedurat hetimore të parashikuara në ligjin ‘Për mbrojtjen e konkurrencës’.

Pas hartimit të raportit hetimor janë zhvilluar seancat dëgjimore më palët nën hetim, seanca në të cilat palët kanë paraqitur pretendimet e tyre në lidhje me raportin e përgatitur nga grupi i punës.

Pas dëgjimit të pretendimeve të palëve dhe prapësimeve të grupit të punës, Komisioni i Konkurrencës, me shumicë votash, ka vendosur që palët nën hetim kanë shkelur nenin 4 të Ligjit lidhur me refuzimin për të njohur abonetë e përgjithshme pa kartonin shoqëruar me logon e shoqatës dhe kufizimin e tregtimit të sasisë së aboneve të studentit për vitet 2007-2012.

Komisioni i Konkurrencës me vendimin 290/datë 23.07.2013 vendosi të gjobisë ndërmarrjet, “Ferrlut” Sha në shumën 1 600 751 lekë, “Tirana Lines “ Sha, në shumën 1 201 698 lekë, “Tirana Urban Trans “ Sha, në shumën 2 130 772 lekë, “ Alba Trans Sh.p.k në shumën 615 434 lekë, “Parku i Autobusëve Urban të Udhëtarëve” Sh.p.k, në shumën 530 903 lekë për shkelje të nenit 4, pika 1, gërma b të ligjit (kufizim sasior të konkurrencës).